

Të nxehtë apo temperaturë e lartë?

Temperatura e trupit të foshnjës tuaj luhetet ndërmjet 36,5 °C dhe 37,5 °C. Temperaturat ndryshojnë nga një foshnjë tek tjetra dhe do të ndryshojnë gjatë gjithë kohës së ditës. Të nxehtit ndodh kur temperatura e fëmijës rritet mbi 38 °C.

Të nxehtit është reagimi normal i trupit ndaj një infeksioni. Të nxehtit nuk është i rrezikshëm dhe nuk është e nevojshme që të trajtohet gjithnjë. Moshë dhe shëndeti i përgjithshëm i fëmijës tuaj janë shumë të rëndësishme nëse fëmija juaj ka të nxehtë. Ndaj vëzhgojeni fëmijën tuaj me kujdes!

SHENJAT PARALAJMËRUESE PËR TË NXEHTIN

- Vështirësi në frymëmarrje
- Foshnja nuk ha e nuk pi
- Të vjella
- Dehidratim; pelena më të thata, buzë dhe gojë e thatë dhe nganjëherë sy të futur Fytyra është e zbehtë dhe gri
- Dhimbje kur preket
- Përgjumje, vështirësi në gjallërimin e fëmijës
- E folur e turbullt
- Qarje me zë të lartë ose zë të dobët
- Ngurtësim i qafës
- Puçrra (urtikarie) të vogla të kuqe si në blu në lëkurë
- Konvulsione

Është më mirë të konsultoheni me një mjek menjëherë nëse vini re një apo më shumë nga simptomat e mësipërme edhe nëse fëmija nuk ka temperaturë të lartë ose ka vetëm pak të nxehtë.

Të nxehtit te një fëmijë më i vogël se 3 muaj

- Shkoni te mjeku kur temperatura është 38 °C ose më e lartë!
- Mos i jepni asnjë bar fëmijës tuaj për temperaturën (një antipiretik) pa këshillën e mjekut.
- Nëse mjeku ju jep me recetë ndonjë bar për nxehtin: Jepni dozën e saktë në mënyrën e duhur.
- Monitoroni gjendjen e përgjithshme të fëmijës tuaj me kujdes gjatë të nxehtit.
- Jepini fëmijës sasi të vogla lëngjesh rregullisht. Jepini fëmijës më shumë qumësht se zakonisht. Nëse jeni duke ushqyer me gji, fëmija mund të ushqehet më shpesh.

Të nxehtit te një fëmijë ndërmjet 3 dhe 6 muaj

- Shkoni te mjeku kur temperatura është 39 °C ose më e lartë!
- Jepni një sasi të vogël mjekimi për temperaturën nëse ka shenja të sikletit të madh (parehati, ka dhimbje ose qan), ose pas këshillës së një mjeku kur prisni për konsultën.
- Jepjani fëmijës mjekimin në mënyrën e duhur dhe përdorni dozën e duhur!
- Mos jepni mjekime të ndryshme së bashku ose pas njëri-tjetrit.
- Monitoroni gjendjen e përgjithshme të fëmijës tuaj me kujdes gjatë të nxehtit.
- Nëse fëmija juaj është më i vogël se 6 muaj mund t'i jepni qumësht shtesë. Nëse jeni duke ushqyer me gji, fëmija mund të ushqehet më shpesh.

Të nxehtit te një fëmijë më i madh se 6 muaj

- Jepni një sasi të vogël mjekimi për temperaturën nëse ka shenja të sikletit të madh (parehati, ka dhimbje ose qan), ose pas këshillës së një mjeku kur prisni për konsultën.
- Jepjani fëmijës mjekimin në mënyrën e duhur dhe përdorni dozën e duhur!
- Mos jepni mjekime të ndryshme së bashku ose pas njëri-tjetrit.
- Monitoroni gjendjen e përgjithshme të fëmijës tuaj me kujdes gjatë të nxehtit.
- Jepini më shumë ujë për të pirë.